



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-1105/21 datë:13.01.2021



Npi – 01/25 datë: 15.01.2020

Në bazë nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 37 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, datë:03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114, datë:26.04.2019, për mbledhjen Përkujtimore të Kuvendit të Komunës, së Shtimes e mbajtur më: 15.01.2021 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S P Ë R K U J T I M O R E T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S

E mbajtur më: 15.01.2021, e (premtë) në ora 09.30h në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, znj.Marigona Pajaziti, znj.Adelina Beqaj, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj.

Përveç delegatëve në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli; Drejtorët, Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi:

R E N D I N E D I T Ë S

1. Hapja e mbledhjes përkujtimore nga Kryesuesja e Kuvendit,
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës,
3. Agjenda për datën: 15 Janar 2021.

Pika 1

Hapja e mbledhjes përkujtimore nga Kryesuesja e Kuvendit

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; I nderuar kryetar i Komunes z.Naim Ismajli, I nderuar nenkryetar z. Rrahman Jakupi, te nderuar keshilltare komunal, drejtore e zyrtar present, te nderuar perfaqesues te institucioneve, I nderuar kryetar I Keshillit te Bashkesise Islame ne Shtime Skender effendi Baftiu, te nderuar perfaqesues te Organizatave te dalura nga lufta, te nderuar afamilje te deshmoreve, veteraneve dhe invalideve te luftes, te nderuar qytetare,

Ne çdo përvjetor me dhimbje dhe krenari kujtojmë më të dashurit tanë, kujtojmë njerëzit e pafajshëm të vvarë në mënyrën më mizore te mundshme vetem pse ishin shqiptar. Në gjithë shekujt e saj, për shqiptarët, muaji i acartë i janarit, është zakonisht muaj i ngricave, por edhe i dhimbjeve të mëdha.

Sot jemim bledhur per shenimin e dites perkujtimore te 15 Janarit, shenimin e 22 vjetorit te Masakres se Recakut. Masakra e Reqakut eshte cmimi i lirise se Kosoves. Recaku eshte rrefimi i dhimbjes dhe krenarise, eshte forca dhe guximi, Reqaku eshte njolla e perhershme e TURPIT ne fytyren e shtetit serb.

Te nderuar te pranishem, Populli yne në rrugetimin e vet për liri u përball me shumë vuajtje e sakrifica nga pushtuesit, por lufta e fundit është epikeja më e lavdishme, sa krenare po aq e

dhimbshme.

Dita e masakres se Reçakut ishte ditë e dhimbjes, por edhe ditë e kthesës historike. Kjo ditë nxiti botën demokratike të rreshtohet në krah të popullit të Kosovës për realizimin e kërkesës legjitime – LIRINE.

Ngjarja që ndodhi në këtë fshat të vogël ndryshoi përgjithmonë historinë e Kosovës. Kosoves që është amaneti i gjeneratave të tëra! Dhe kete amanet ne duhet ta qojme ne vend, për ta bërë shtetin e krenarisë për të gjithë ata që sakrifikuan, për ne që sot po e ndërtojmë dhe për gjeneratat e reja që do ta gëzojnë. Ne sot përkulemi me nderim dhe respekt për martirët dhe dëshmorët e Reçakut dhe ndajmë dhimbjen dhe pikëllimin me familjarët të cilët i humbën më të dashurit e tyre që Kosova ta fitojë lirinë.

Lavdi deshmorëve dhe martirëve te Reçakut!

I perjetshem qofte kujtimi per te gjithe te renet qe sollen lirine ne vendin tone!

Pika 2

Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës

Kryetari, z.Naim Ismajli; Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Te nderuar perfaqesues te Organizatave te dalura nga lufta, te nderuar afamilje te deshmorëve, veteraneve dhe invalideve te luftes, te nderuar qytetare, sot po e përkujtojmë 22 vjetorin e Masakrës që ndodhi në agimin e hershëm të 15 Janarit 1999, në fshatin Reçak. Në vazhdim, lexoi shkresën e përgatitur për mbledhjen përkujtimore, (shih dokumentin).


Pika 3

Agjenda për datën: 15 Janar 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Faleminderit kryetar, në vazhdim ju njoftoj se do ta ndjekim agjendën e përgatitur për sot. Do të vazhdojmë për homazhe te Kompleksi përkujtimor i varrezave të martirëve në Reçak.

Mbledhjen përkujtimore Kryesuesja znj.Medina Brahaj e përfundoi në ora 9.54h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

